

V E N D I M
Nr.291 datë 14.6.1993

PËR FORCIMIN E METEJSHËM TË EMBARGOS NDAJ SERBISË DHE MALIT TË ZI

Në vijim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.536, datë 21.12.1992 "Për zbatimin e detyrave nga ministrinë për embargon ndaj Serbisë dhe Malit të Zi", si dhe në mbështetje të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB nr.820, datë 17.4.1993 "Për forcimin e mëtejshëm të sanksioneve ndaj Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbisë e Malit të Zi)", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë të marrin të gjitha masat për të ndaluar çdo lloj eksporti mallrash të destinuara për në Serbi dhe Mal të Zi.

Të ndalohen të gjitha tranzitimet për të gjitha llojet e mallrave, të cilat nga territori i vendit tonë kalojnë nëpër territoret e Serbisë dhe Malit të Zi, me përjashtim të ndihmave humanitare në ilaçe dhe ushqime, kur për to në çdo rast të veçantë autorizohet ky tranzitim nga Komiteti i krijuar në bazë të rezolutës nr.724(1991) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Gjithashtu të ndalohen të gjitha importet e të gjitha llojeve të mallrave nga Serbia dhe Mali i Zi.

2. Importimi dhe eksportimi në zonat nën kontrollin e OKB-së në Republikën e Kroacisë dhe në zonat e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës që gjenden nën kontrollin e forcave serbe në Bosnjë, mund të lejohen vetëm me autorizim të veçantë të qeverisë së Kroacisë dhe të Bosnjë-Hercegovinës.

Ministria e Punëve të Jashtme të përcaktojë zonat nën ndikimin e OKB-së në Kroaci dhe zonat nën ndikimin e forcave serbe të Bosnjës në Republikën e Bosnjë-Hercegovinës dhe për çdo ndryshim të tyre të njoftojë menjëherë Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, Ministrinë e Rendit Publik dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Banka e Shqipërisë dhe të gjitha organet shtetërore të bllokojnë fondet e të gjitha ndërmarrjeve nga Serbia ose Mali i Zi, si dhe të ndërmarrjeve të përbashkëta me partner në Serbi ose Mal të Zi, të cilat ushtrojnë veprimtari në fushat tregtare, industriale a publike në vendin tonë.

Gjithashtu këto organe të ndalojnë transferimin e fondeve për qëllime tregtare në Serbi ose Mal të Zi.

4. Nëse në vendin tonë hyjnë anije, mjete të transportit rrugor të mallrave, vagonë hekurudhorë e avionë, që janë pronë e ndërmarrjeve ose personave nga Serbia a Mali i Zi, ose punojnë për interesa të ndërmarrjeve a të personave të Serbisë ose Malit të Zi, të bëhet sekuestrimi i tyre dhe i mallit.

Gjithashtu nëse vërtetohet se anije, mjete rrugore të transportit të mallrave, vagonë hekurudhe e avionë që ndodhen në vendin tonë, kanë shkelur rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB 757 (1992), 787 (1992) dhe 820 (1993), të bllokohen dhe mallrat e tyre të sekuestrohen.

Të gjitha shpenzimet për sekuestrimet t'u ngarkohen pronarëve të mjeteve dhe mallrave.

5. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve të marrin masa për ndalimin e kalimit, qëndrimit ose të nisjes së anijeve dhe avionëve nga vendi ynë me destinacion përfundimtar Serbinë dhe Malin e Zi.

6. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të marrë masa për të bllokuar kalimin e automjeteve për transport mallrash në pikat kufitare Morinë dhe Qafë-Prush, kurse pika kufitare e Hanit të Hotit të kufizohet vetëm për kalimin e automjeteve të transportit të mallrave të autorizuar nga Komiteti i krijuar mbi bazën e rezolutës 724 (1991) të OKB-së.

Gjithashtu të bllokohet edhe kalimi i mjeteve hekurudhore në pikën kufitare të Bajzës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

